

VENDIM
Nr. 846, datë 24.12.2019

**PËR MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN ZYRTAR TË NOMENKLATURËS SË
KOMBINUAR TË MALLRAVE, 2020¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 12, të ligjit nr. 9461, datë 21.12.2005, “Për Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave dhe tarifën e integruar doganore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2020, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 775, datë 26.12.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2019”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2020 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

¹ Ky vendim është përafruar pjesërisht me rregulloren zbatuese të Komisionit (EU) 2019/1776, amendim i rregullores së Këshillit Evropian (EEC) nr. 2658/87, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 280, datë 31.10.2019.